REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

DREJTORIA GJYQËSORE DHE E DOKUMENTACIONIT

S H P A LL J E

Në datën **11.11.2026, ora 11:00** Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë do të zhvillojë seancën plenare mbi bazë dokumentesh për kërkesën me kërkues Kadri Pazari, Zana Shima, Kujtim Pazari, Greta Beliu (Pazari), Ami Narazani, Marla Narazani, Adrian Narazani, Lirije Pazari, Jona Pazari, Jeta Xhema, Etleva Zeqo, Rezarta Dobra, Ermira Luzi, Engjell Kazazi, Ndriçim Kazazi, Fatbardha Rama, Donika Xhaferri, Hiqmete Memija, Drita Çaçi, Leonardo Çaçi dhe Juel Çaçi me objekt: *"1. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2408, datë 18.06.2025 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 386, datë 13.02.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 3. Shfuqizimin e vendimit nr. 7239, datë 25.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë"*, dhe subjekte të interesuara Agjencisë së Trajtimit të Pronës Bashkia Tiranë, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë dhe Aqif Çuni.

Për subjektin e interesuar në këtë gjykim Aqif Çuni, me adresë: *Rruga "Babë Rexha", shtëpi private, Tiranë,* bazuar në nenin 38, pika 3, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe nenet 133/a dhe 133/b të Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se vendqëndrimi i këtij subjekti të interesuar nuk është i saktë, bëjmë këtë shpallje.

Tiranë, më 07.10.2026